

KOSOVA- BE 2.0

Hapat e ardhshëm në procesin integrues të Kosovës

KOSOVA- BE 2.0

Hapat e ardhshëm në procesin integrues të Kosovës

Shtator 2020, Prishtinë

Titulli i publikimit:

KOSOVA-BE 2.0: Hapat e ardhshëm në procesin integruar të Kosovës

Publikuar nga:

Instituti i Kosovës për Politikën Evropiane

Vendi dhe koha e publikimit:

Prishtinë, Shtator 2020



Ky raport është hartuar me mbështetjen e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur, KFOS. Përmbajtja e tij është përgjegjësia e vetme e Institutit të Kosovës për Politikën Evropiane dhe në asnjë formë nuk pasqyron pikëpamjet e Fondacionit për Shoqëri të Hapur, apo KFOS-it.

(faqe qëllimisht lënë zbrazët)

PËRMBAJTJA

Shkurtesat	6
Hyrja	8
Liberalizimi i vizave	9
Marrëveshja Stabilizim Asocimi	16
Agjenda Evropiane e Reformave	21
Raporti për Kosovën	23
Përgatitjet për statusin e Vendit Kandidat për Anëtarësim në BE	26
Instrumenti i Asistencës së Para-Anëtarësimi	31
Donacionet bilaterale	33
Rekomandimet	38
Lista e figurave	41

SHKURTESAT

AER	Agjenda Evropiane e Reformave
AIE	Agjencia për Integrim Evropian
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BHV	Bruto të Hyrat Vendore
BNK	Bashkëpunimi Ndër Kufitar
BPV	Bruto Produkti Vendor
COREPER	Komiteti i Përfaqësuesve të Përhershëm
COSME	Programi për Konkurrueshmerinë e NVM-ve
COWEB	Grupi Punues për Ballkanin Perendimor
DAZH	Departamenti i Asistences Zhvillimore
DESI	Indeksi i Ekonomisë dhe Shoqërisë Digjitale
DG NEAR	Drejtorati i Përgjithshëm për Fqinjësi dhe Negociatat e Zgjerimit
DIEKP	Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave
DP	Dokumentet e Programimit
DPS	Dokumente Planifikuese Sektoriale
EaSI	Programi për Punësim dhe Inovacion Social
EJL	Evropa Jug Lindore
ERP	Programi për Reforma Ekonomike
ETC	Bashkëpunimi Territorial Evropian
FNL	Forumi Nivelit të Lartë
FP 7	Programi Kornizë për Hulumtim dhe Zhvillim Teknologjik
FWA	Marrëveshja Kornizë
GAC	Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme
GNP	Grupe Nën-sektoriale të Punës
GSP	Grupe Sektoriale të Punës
IPA I	Instrument i Para-Anëtarësimit 2007-2013
IPA II	Instrument i Para-Anëtarësimit 2014-2020
IPA III	Instrument i Para-Anëtarësimit 2021-2027
IPS	Planifikimi i Integruar Strategjik
ISP	Instrumenti për Stabilitet dhe Paqe
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KB	Kombet e Bashkuara
KE	Komisioni Evropian

KFOS	Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
KKI	Komiteti Kombëtar i Investimeve
KNIE	Komiteti Ndër-institucional për Integrim Evropian
M&R	Monitorimi dhe Raportimi
MAP	Plani Shumëvjeçar për Hapësirën Ekonomike Rajonale
MFF	Korniza Shumëvjeçare Financiare
MSA	Marrëveshja Stabilizim Asocimi
NIPAC	Koordinatori Kombëtar i IPA-së
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
ONP	Organizata Ndërkombëtare e Punës
PE	Parlamenti Evropian
PKZMSA	Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së
PMN	Platforma për Menaxhimin e Ndihmës së Huaj
PSA	Procesi Stabilizim Asocimi
QeQ	Qendra e Qeverisjes
SDG	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
SI	Strategjia Indikative për IPA
SIGMA	Mbështetje për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Menaxhimit
ShA	Shteti Anëtar
TBE	Traktati i BE-së
TFBE	Traktati mbi Funkcionimin e BE-së
WBIF	Korniza Investuese për Ballkanin Perëndimor
YCS	Skema e Profesionistëve të Rinj

HYRJA

Integrimi evropian mbetet prioritet kyç nacional i Kosovës. 90% e qytetarëve konsiderojnë se anëtarësimi në BE është gjë pozitive për vendin.

Sidoqoftë, Kosova është në fillimin e procesit integruar. Rruga e saj integruar është karakterizuar me shumë sfida komplekse. Kosova ka shpallur pavarësinë në vitin 2008, por është dashur pesë vite për të marr hapin e parë në rrugën integruar, respektivisht të fillohen negociatat për Marrëveshjen Stabilizim Asociativ (MSA). Ndërsa, dymbëdhjetë vite pas shpalljes së pavarësisë Kosova nuk ka lëvizur përtej MSA-së. Liberalizimi i vizave nuk është finalizuar as tetë vite pas lansimit të tij.

Në këtë kontekst, ky publikim synon të identifikoj shtigjet e ndryshme përmes të cilave Kosova do të mund të avancoj marrëdhëniet Kosovë – BE në një nivel të ri.

Ky publikim duhet të shërbej institucioneve të Kosovës si kontribut në përcaktimin e prioritetëve dhe hapave në procesin integruar.

Publikimi përbëhet nga VII kapituj. Liberalizimi i vizave do jetë temë e kapitullit I. Në kapitullin II dhe III do flasim për dy tema të ndërlidhura: Marrëveshjen Stabilizim Asociativ dhe Agjendën Evropiane të Reformave (ERA). Në kapitullin IV do flasim për mënyrat se si mund të sigurojmë një zbatim më të mirë të rekomandimeve që dalin nga Raporti i rregullt vjetor i Komisionit Evropian për Kosovën. Në kapitullin V do shqyrtojmë disa idetë lidhur me përgatitjet që Kosova duhet të bëjë për statusin e vendit kandidat. Ndërsa, në kapitullin VI dhe VII do flasim për Instrumentin e Asistencës Para-Anëtarësimi (IPA) dhe koordinimin e donacioneve.

Në këto shtatë fusha ne kemi identifikuar 35 rekomandime specifike. Ne shpresojmë se këto rekomandime do asistojnë institucionet shtetërore në ndërmarrjen e reformave që na presin në rrugën tonë integruar.

Në fund, dëshirojmë të falënderojmë institucionet e Kosovës dhe Komisionin Evropian (KE). Shumica e asaj që do të gjeni këtu është bërë e mundur me mbështetjen e tyre bujare. Dhe sigurisht dëshirojmë të falënderojmë Fondacionin e Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) i cili e njohu rëndësinë e këtij projekti dhe pa mbështetje të të cilit e gjithë kjo nuk do të ishte e mundur.

I. LIBERALIZIMI I VIZAVE

Ideja e liberalizimit të vizave për vendet e Ballkanit Perëndimor u prezantua në Samitin e Selanikut në qershor 2003. Këshilli propozoi një listë reformash që duhet të ndermirën për të fituar të drejtën e lëvizjes së lirë në zonën Shengen.

Në qershor 2012, Kosova pranoi udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave me gjithsej 95 kritere. Kosova miratoi Planin e Veprimit për Zbatimin e Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave dhe filloj ndërmarrjen e reformave në këto fusha: ripranimi dhe riatdhesimi i qytetarëve, siguria e dokumenteve, menaxhimi i kufijve, azili, migrimi, siguria publike, si dhe liria e lëvizjes dhe të drejtat themelore.

Figura 1: Kriteret e udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave



Përgjatë tetë viteve, Komisioni Evropian ka përgatitur pesë raporte për progresin e Kosovës në zbatimin e udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave. Me 18 korrik 2018, Komisioni ka publikuar raportin e fundit për zbatimin e kritereve nga udhërrëfyesi për liberalizimin e vizave, duke konfirmuar se “të gjitha kriteret nga udhërrëfyesi për liberalizimin e vizave janë përmbushur.”

Me 24 shtator 2019, Komiteti i Parlamentit Evropian për Liritë Qytetarë (LIBE) ka mbështetur liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës.

Që nga ajo kohë, Këshilli i BE-së nuk ka arritur të këtë konsensus përkitazi me çështjen e liberalizimit të vizave. Një numër i vendeve anëtare nuk e ndajnë vlerësimin e KE-së që Kosova ka bërë progres të mjaftueshëm në fushën e sundimit të ligjit, ndërsa po ashtu ata kanë ngritur vërejtjet e tyre për nivelin e lartë të migrimit të qytetarëve të Kosovës në zonën Shengen.

Ekzistojnë katër sfidat kryesore me të cilat ballafaqohet Kosova në procesin e liberalizimit të vizave:

1. Mungesa e rezultateve në kuadër të luftës kundër korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimin të organizuar. Katër vite pas kërkesës së Komisionit Evropian për përmbushjen e kriterit të luftës kundër krimin të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë, ne ende s'kemi asnjë aktgjykim dënues të profilit të lartë për korrupsion. Rastet e interesit të lartë publik, sikur "PRONTO" dhe rasti "FAJDET" nuk kanë arritur të kthejnë besimin në institucionet e sundimit të ligjit.

2. Raporti i Vendit 2019 identifikoj sfida të shumta në fushën e sundimit të ligjit. Në veçanti, vendet anëtare me shqetësim janë duke përcjell gjeturat e Raportit të Vendit, ku është konkluduar se korrupsioni është i përhapur në të gjitha nivelet institucionale dhe institucionet e drejtësisë janë duke ndërmarr veprimet nën ndikimin politik. Kosova u konfirmua se është vend i fundit në Ballkan në kuadër kapitujve të ndërlidhur me sundimin e ligjit – kapitulli 23 dhe 24.

3. Ngecjet në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë – Serbi. Mungesa e progresit në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë është një pengese indirekte pasi që vendet anëtare të BE-së e shohin bashkëpunimin rajonal si parakusht themelor në kuadër të gjitha proceseve integruese, përfshire edhe liberalizimin e vizave.

4. Mungesa e vullnetit politik për liberalizim të vizave. Kosova ka pasur momentumin pozitiv për liberalizimin e vizave në vitin 2016, sidoqoftë sot çështja e hapjes së kufijve është çështje me implikime të shumta politike brenda disa vendeve anëtare të BE-së.

Me qëllim të adresimit të këtyre sfidave, institucionet e Kosovës duhet të bëjnë progres në 4 drejtime:


1. Arritja e rezultateve në kuadër të luftës kundër korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimin të organizuar. Në kuadër të mekanizmit për përcjelljen e rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimin të organizuar, Kosova ka shënjestruar 62 raste të korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimin të organizuar. Është shumë e rëndësishme që sistemi i sundimit të ligjit të dëshmoj pavarësinë e vet duke bërë progres në luftë kundër korrupsionit të nivelit të lartë.

2. Vullneti i qartë politik për reformat e sundimit të ligjit. Së fundi, institucionet kanë treguar vullnet politik për të ndërmarr reformat strukturore dhe për të krijuar një mjedis progresiv politik me zero tolerancë ndaj korrupsionit. Në këtë drejtim, Qeveria ka anuluar procedurën kontroverse për ndërtimin e autostradës prej 110 milion euro, si dhe procedurën kontroverse për emërimin e noterëve. Konsiderojmë se hapat sikur këto duhet të vazhdojnë me qëllim të ndërtimit të një mjedisi politik në mbështetje të sundimit të ligjit.

3. Progres në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve. Që nga publikimi i Strategjisë së Zgjerimit në shkurt 2018, BE-ja ka nënvizuar se: “Marrëveshja gjithëpërfshirëse ligjërishit e obligueshme për normalizimin e marrëdhënieve është urgjente në mënyrë që Serbia dhe Kosova të avancojnë rrugën e tyre Evropiane.” Së fundi, BE-ja ka emëruar Përfaqësuesin e Posaçëm për Dialogun Beograd – Prishtinë detyra e të cilit është të arrij normalizimin e plotë të marrëdhënieve në mes Kosovës dhe Serbisë përmes marrëveshjes gjithëpërfshirëse ligjërishit të obligueshme e cila adreson të gjitha çështjet e hapura në mes të palëve dhe në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe stabilitetin rajonal.

4. Komunikimi i shtuar me vendet anëtare të BE-së. Kosova duhet të intensifikojë komunikimin me vendet anëtare në të gjitha nivelet, me theks të veçantë në aspektet e zgjerimit të cilat ndërlidhen me çështjet e brendshme politike të vendeve anëtare. Kjo kërkon komunikimin dhe koordinimin e afërt me ambasadat tona në vendet anëtare të BE-së, si dhe ambasadat e vendeve anëtare të BE-së në Kosovë. Po ashtu, shoqëria civile, media dhe përfaqësues të akademisë duhet të janë të përfshirë. Vëmendje e veçantë duhet të kushtohet çështjeve të interesit kyç për vendet anëtare sikur që janë sundimi i ligjit dhe migrimi.

Figura 2: Si të adresohen sfidat e liberalizimit të vizave?



Sa i përket hapave të ardhshëm në kuadër të liberalizimit të vizave për Kosovën, para Kosovës janë edhe gjashtë hapa të tjera.

Figura 3: Hapat e ardhshëm për liberalizimin e vizave për Kosovën

- 1** KE propozon plotësim-ndryshimin e Rregullores 539/2001
- 2** PE mandaton LIBE për fillimin e negociatave ndër-institucionale (dialogu)
- 3** Mbyllja e negociatave dhe arritja e marrëveshjes së përkohshme për tekstin e plotësuar-ndryshuar të Rregullores
- 4** LIBE & COREPER votojnë plotësim-ndryshimin e Rregullores
- 5** Seanca plenare e PE-së miraton plotësim-ndryshimin e Rregullores
- 6** Këshilli i BE-së voton plotësim-ndryshimin e Rregullores
- 7** Ceremonia e nënshkrimit
- 8** Hyrja në fuqi e Rregullores 539/2001 (20 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të BE-së)

Duke shikuar përtej ditës kur Kosova do përfitoj nga liberalizimi i vizave, është e rëndësishme që institucionet të fillojnë përgatitjet për skenarin pas-liberalizimit të vizave. Në këtë kontekst është e rëndësishme që qytetarët e Kosovës të janë të informuar për të drejtat dhe obligimet që burojnë nga procesi i liberalizimit të vizave. Në këtë drejtim, Kosova do të monitorohet në kuadër të mekanizmit për pezullimin e liberalizimit të vizave në mënyre që të sigurohet se regjimi i vizave nuk përfaqëson ndonjë rrezik për BE-në.

Mekanizmi për pezullimin e liberalizimit të vizave mund të aktivizohet në këto rrethana:

- Rritja e ndjeshme e nivelit të migrimit të jo-rregullt (më shumë se 50%), përfshirë personat të cilat janë zënë ilegalisht, dhe personat të cilëve iu është refuzuar hyrja në kufij;
- Rritja e ndjeshme (më shumë se 50%) e kërkesave për azil me shkallë të ulët të njohjes së drejtës së azilit (rreth 3-4%);
- Rënia e bashkëpunimit për ripranim, respektivisht rritja e shkallës së refuzimit të aplikacioneve të ripranimit;
- Rreziku i shtuar për sigurinë e vendeve anëtare, me theks të veçantë në krimet e rënda.

Po ashtu, Komisioni Evropian mund të aktivizoj mekanizmin në raste kur Kosova nuk përmbush më kriteret që burojnë nga udhërrëfyti për liberalizimin e vizave.

Figura 4: Kriteret e mekanizmit për pezullimin e liberalizimit të vizave



RRITJA E MIGRIMIT TË JO-RREGULLT



RRITJA E KËRKESAVE PËR AZIL ME SHKALLË TË ULËT TË NJOHJES SË DREJTËS SË AZILIT



RRITJA E SHKALLËS SË REFUZIMIT TË APLIKACIONEVE TË RI-PRANIMIT



RREZIKU I SHTUAR PËR SIGURINË E VENDEVE ANËTARE TË BE-SË, ME THEKS TË VEÇANTË NË KRIMET E RËNDA




REGRES NË ZBATIMIN E KRITEREVE TË UDHËRRËFYESIT PËR LIBERALIZIMIN E VIZAVE

II. MARRËVESHJA STABILIZIM ASOCIMI

Kosova është në fillimet e procesit të integrimit Evropian. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) hyri në fuqi më 1 prill 2016. MSA ka vulosur orientimin strategjik të Kosovës për t'u anëtarësuar në BE dhe ka krijuar korniz formale dhe kontraktuale për arritjen e këtij qëllimi.

Figura 5: Procesi integruar i vendeve të Ballkanit Perëndimor



Ne aspektin politik, MSA ka vendosur kornizën ligjore të bashkëpunimit brenda së cilës Kosova duhet të përafrojë dhe zbatoj legjislacionin e BE-së. Ndërsa në aspektin ekonomik, MSA-ja ka paraparë kalendarin kohor brenda së cilit do të bëhet liberalizimi i plotë i tregut ndërmjet Kosovës dhe BE-së.

Rëndësia e MSA-së pasqyrohet më së miri në faktin që BE-ja dhe Kosova nuk do nënshkruajnë më asnjë marrëveshje deri në Traktatin e Anëtarësimit.

MSA në 600 faqe, X tituj, 7 shtojca dhe 5 protokolle, rregullon pothuajse çdo aspekt të jetës së përditshme të qytetarëve. MSA është themel i procesit të integrimit evropian.

Mbi bazën e titullit X të MSA-së, Kosova dhe BE-ja kanë ngritur strukturat institucionale përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të MSA-së:

- Këshilli i Stabilizim-Asocimit;

- Komiteti i Stabilizim-Asocimit;
- Shtatë nënkomitete të Stabilizim-Asocimit dhe dy Grupe të Posaçme të Punës (GPP);
- Komiteti Parlamentar i Stabilizim-Asocimit.

Këshilli i SA, siç përcaktohet në nenin 126 të MSA-së, është përgjegjës për mbikëqyrjen e aplikimit dhe zbatimit të MSA-së. Duke marrë parasysh këtë gjë, dhe me qëllim arritjen e objektivave të Marrëveshjes, këshilli ka fuqinë të marrë vendime brenda fushëveprimit të MSA-së. Vendimet e marra janë detyruese për Palët, të cilat duhet të marrin masat e nevojshme për të zbatuar vendimet e marra. Përpos kësaj, Këshilli i SA-së mund të bëjë rekomandimet përkatëse. Këshilli bashkëdrejtohet nga Ministri i Punëve të Jashtme të Kosovës dhe Përfaqësuesi i Lartë i BE-së.

Në misionin dhe detyrat e tij, Këshilli i SA-së asistohet nga një Komitet i Stabilizim-Asocimit. Komiteti bashkëdrejtohet nga Ministri i Kosovës për Integrim Evropian dhe Drejtori për Ballkanin Perëndimor/DG NEAR.

Nënkomitetet e SA-së dhe dy grupe punuese (dialogu dhe reforma e administratës publike) mbulojnë kapituj me tematika të ndryshme të acquis. Ata bashkëdrejtohen nga Sekretarët e Përgjithshëm të ministrisë përkatëse në Kosovë dhe nga Drejtuesi i Njësisë së DG NEAR në Kosovë.

Komiteti Parlamentar për Stabilizim-Asocim është një forum ku Anëtarët e Parlamentit Evropian dhe Anëtarët e Parlamentit të Kosovës mund të mblidhen, të shkëmbejnë mendime dhe të mbështesin procesin. Ai bashkëdrejtohet nga përfaqësuesi i Kuvendit të Kosovës dhe Parlamentit Evropian.

Bazuar në MSA, palët – Kosova dhe BE-ja, kanë ndërmarrë detyrime të ndërsjella për të realizuar në mënyrë progresive dhe të plotë asocimin brenda një periudhe dhjetëvjeçare.

Obligimet e Kosovës që rrjedhin nga MSA mund të ndahen në dy kategori:

- Detyrimet e përgjithshme të Kosovës për t'u angazhuar në dialog progresiv politik dhe për të zbatuar rregullat e BE-së në të gjitha kapitujt e acquis;
- Detyrimet specifike të Kosovës, të cilat duhet të përmbushen brenda periudhës së caktuar kohore.

Në këtë drejtim, Kosova ka marr përsipër 29 obligimeve konkrete të cilat duhet të zbatohet deri në vitin 2026:

2016

- Hiqen tarifat doganore
- Trajtimi i barabartë i monopoleve shtetërorë që kanë karakter komercial
- Trajtimi i barabartë në themelimin e ndërmarrjeve
- Trajtimi i barabartë i degëve të ndërmarrjeve
- E drejta e ndërmarrjeve të BE-së dhe degëve të tyre për marrje me qira të patundshmërive
- Qasje pakushtëzuar në trafikun tranzit
- Lëvizja e lirë e kapitalit i cili është i lidhur me investimet direkte dhe kredive të lidhura me transaksionin komercial apo ofrimin e shërbimeve
- Trajtim jo më pak i favorshëm se vendeve të treta lidhur me njohjen dhe mbrojtjen e pronësisë intelektuale, industriale dhe komerciale
- Qasje e barabartë e ndërmarrjeve të dy palëve në prokurimet publike
- Ndihma shtetërore vlerësohet në harmoni me nenin 107.3 të Traktatit të BE-së

2017

- Aplikimi i mëtutjeshëm gradual i rregullave të BE-së për lëvizjen e lirë të kapitalit

2018

- Këshilli përcakton modalitete për aplikimin e plotë të rregullave të BE-së për lëvizjen e lirë të kapitalit në Kosovë
- Kosova përfundon negociatat për të gjitha konventat bilaterale për bashkëpunim rajonal
- Këshilli shqyrton hapat e nevojshëm për njohjen e ndërsjellët të kualifikimeve për profesionet e rregulluara

2019

- Këshilli shqyrton mundësinë e liberalizimit të mëtutjeshëm të tregtisë të produkteve bujqësore dhe peshkatarisë
- Kosova fillon aplikimin e parimeve të BE-së për ndërmarrjet publike, dhe ndërmarrjet të cilat gëzojnë të drejtat e veçanta dhe ekskluzive
- Kosova finalizon regjistrin e ndihmës shtetërore, dhe siguron se çdo ndihmë shtetërore e ofruar nga viti 2020 është në përputhje me rregullat e BE-së

2020

- Kosova dorëzon të dhënat e Bruto Produktit Vendor për kokë banori, në nivelin NUTS II
- Kosova siguron të drejtat reciproke lidhur me migrimin legal të shtetasve të BE-së

2021

- Kosova siguron mbrojtje të indikatorëve gjeografik të BE-së
- Ndërmarrjet e BE-së fitojnë të drejtën e pronësisë së patundshmërive në Kosovë
- Kosova ofron trajtim të barabartë shtetaseve të BE-së të cilët zotërojnë patundshmëri në Kosovë
- Këshilli Stabilizim Asocimi bënë vlerësimin e parë detaj të zbatimit të MSA-së
- Këshilli Stabilizim Asocimi merr masa nevojshme për zbatimin progresiv të ofrimit të shërbimeve nga qytetarët dhe ndërmarrjet e BE-së dhe Kosovës
- Kosova garanton mbrojtje të të drejtave intelektuale, industriale dhe komerciale, në nivel të njëjte të mbrojtjes siç është në BE
- Kosova miraton legjislacion për prokurim publik i cili siguron zbatimin e standardeve procedurale të përcaktuara me legjislacion të BE-së
- Kosova miraton legjislacionin e BE-së në fushën e rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve të komunikimit elektronik

2022

- Këshilli vendos modalitetet për zgjerimin e dispozitave të MSA-së përkitazi me ofrimin e shërbimeve

2023

- Këshilli bënë vlerësimin e dytë detaj të zbatimit të MSA-së

2026

Asocimi në mes Kosovës dhe BE-së është arritur plotësisht.

Me qëllim të planifikimit të reformave të MSA-së, Qeveria miraton në baza vjetore Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA). PKZMSA është dokumenti kryesor qeveritar që përpiket të zbatojë dispozitat që rrjedhin nga MSA. PKZMSA përcakton një kornizë afatmesme gjithëpërfshirëse të të gjitha reformave të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të MSA-së, konkretisht masat dhe prioritetet për përafrimin gradual të legjislacionit me acquis, përmes transpozimit të këtij të fundit, si dhe për zbatimin e legjislacionit të përafruar. PKZMSA përfshin veprime në lidhje me zbatimin e masave afatshkurtra që adresojnë kërkesat sipas 33 kapitujve të acquis.

Monitorimi dhe raportimi mbi zbatimin e PKZMSA-së bëhet përmes monitorimit online. AIE-ja përgatit raportet kuartale dhe vjetore.

Në këtë drejtim, sfida kryesore me zbatimin e MSA-së është mungesa e vullnetit politik për zbatimin e reformave:

- Në vitin 2016, programi kishte 1,347 masa – nga të cilat institucionet arritën të përmbushin 741 masa, apo 55% të programit.
- Në vitin 2017, programi kishte 967 masa – nga të cilat institucionet arritën të përmbushin 600 masa, apo 62% të programit.
- Në vitin 2018, programi kishte 532 masa – nga të cilat institucionet arritën të përmbushin 362 masa, apo 68% të programit.
- Në vitin 2019, programi kishte 401 masa – nga të cilat institucionet arritën të përmbushin 204 masa, apo 51% të programit.

Viti i ardhshëm do jetë i një rëndësie të veçantë pasi që do bëhet rishikimi 5-vjeçar i zbatimit të MSA-së. Në këtë drejtim, Qeveria duhet të shtoj përpjekjet e saja për zbatimin e MSA-së. Rrjedhimisht ne propozojmë katër masa specifike:

1. **Indeksi i progresit për MSA:** janë 29 detyrime specifike të cilat duhet ti zbatoj Kosova. Është me rëndësi që Qeveria të krijoj një instrument të veçantë përmes të cilit mund të monitoroj progresin në kuadër të përmbushjes së këtyre 29 detyrimeve.
2. **Indikatorët e përafrimit me acquis për secilin kapitull:** Është me rëndësi që Kosova të përcaktoj indikatorë dhe matës të qartë se ku qëndron në përafrimin e legjislacionit të Kosovës me legjislacionin e BE-së brenda secilit nga 33 kapituj të legjislacionit të BE-së. Kjo do i lejoj Kosovës që të merr vendime të mirë-informuara sa i përket hapave të radhës dhe prioriteteve në procesin integruar.
3. **Takime mujore të trupave ndër-qeveritar për integrim Evropian:** Qeveria ka krijuar një strukturë koordinuese për integrim evropian e cila përbëhet nga 3 nivele të koordinimit. Sidoqoftë, këto struktura funksionojnë mbi baza ad-hoc dhe pa një lidhshmëri politik dhe qartësi operationale. Zakonisht datat e takimeve përcaktohet disa ditë para takimit, ndërsa qëllimi i takimeve është i pa qartë për shumicën e pjesëmarrëseve. Takimet politike vuajnë nga mungesa e vullnetit politik, ndërsa takimet teknike vuajnë nga mungesa e llogaridhënies.
4. **Raporti kuartal në Qeveri dhe Kuvend.** Qeveria dhe Kuvendi do të duhej të diskutonin mbi baza kuartale progresin dhe sfidat në zbatimin e MSA-së.

III. AGJENDA EVROPIANE E REFORMAVE

Në nëntor 2016, u lansua Agjenda Evropiane e Reformave (ERA) nga Kryeministri i Kosovës, dhe Komisioneri për politikat e fqinjësisë evropiane dhe negociatave për Zgjerim i BE-së.

Qëllimi i Agjendës Evropiane të Reformave është që të përzgjidhen prioritetet kyçe të MSA-së me qëllim të avancimit të perspektives Evropiane të Kosovës dhe përmirësimit të jetës së qytetarëve.

Në nëntor 2016, ishin identifikuar gjithsej 22 prioritet që është dashur të përmbushen deri në fund të vitit 2017. Prioritetet ishin bazuar në 3 shtylla kyçe: (1) sundimi i ligjit, qeverisja e mirë (2) konkurrueshmëria, mjedisi biznesor, si dhe (3) arsimit dhe punësimi.

Katër vite pas lansimit të ERA-s, vetëm 5 nga 22 prioritetet janë përmbushur. Arsyeja kryesore për nivelin e ultë të zbatimit të ERA-s është mungesa e vullnetit politik për të zbatuar reformat që burojnë nga procesi integruar.

Nëse Kosova synon të fitojë statusin e vendit kandidat për anëtarësim në BE, atëherë është jashtëzakonisht e rëndësishme që të intensifikohet shpejtësia e zbatimit të ERA-s.

Janë disa mësimet që mund të nxjerrim nga zbatimi aktual i ERA-s:

- **Prioritetet janë shumë të përgjithshme:** disa nga prioritetet e ERA-s flasin për “ngritjen e kapaciteteve” dhe “zbatimin e ligjeve/strategjive”. Prioritetet të cilat janë kaq të përgjithshme e bëjnë matjen dhe monitorimin e pamundshëm.
- **Mungesa e llogaridhënies:** pas lansimit të ERA-s, Qeveria nuk ka krijuar mekanizmat e nevojshëm institucional për të monitoruar zbatimin e ERA-s. AIE ka përgatitur raporte të rregullta, por këto raporte nuk kanë gëzuar vëmendjen e nevojshme politike.
- **Mungesa e incentives:** Proceset sikur ERA ekzistojnë në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Sidoqoftë këto procese janë ngushtë të lidhura me rrugëtimin formal të integritit të vendit në BE. Për shembull në Shqipëri, procesi i ERA-s është “prioritetet kyçe për nisjen e negociatave të anëtarësimit”.

Rrjedhimisht, incentiva për të bërë progres është shumë më e qartë dhe e drejtpërdrejt. Në rastin e Kosovës, ERA vuan nga mungesa e qartësisë së avancimit të Kosovës drejt BE-së.

Duke shikuara para nesh, Kosova dhe BE duhet të dakordojnë një listë të veprimeve konkrete të cilat duhet të zbatohen nën ombrellën e ERA 1. Një gjë e tillë do të shtroj rrugë për përmbylljen e ERA 1 dhe kalimin në ERA 2.

Nga ana tjetër, ERA 2 duhet të udhëhiqet nga tre parime kyçe:

- 1. Prioritetet specifike:** prioritetet e ERA-s duhet të janë strategjike, specifike, të matshme dhe të orientuara nga ndikimi në ndryshimin e qeverisjes dhe jetës së përditshme të qytetarëve. Një qasje e tillë do të lejoj institucioneve që të fokusojnë të gjitha resurset e tyre në zbatimin e disa prioriteteve kyçe dhe të matshme. Po ashtu, një qasje e tillë do të lejoj Komisionit Evropian që të bëjë një matje më efektive të zbatimit të reformave;
- 2. Mekanizmi efektiv i monitorimit:** ndryshe nga MSA, ERA është më e fokusuar dhe e kufizuar në kohë. Rrjedhimisht, zbatimi i ERA-s kërkon një qasje më pro-aktive. Në këtë drejtim, qeveria duhet të mbaj takimet e rregullta mujore mbi zbatimin e prioriteteve të ERA-s.
- 3. Gjithëpërfshirja:** Kuvendi dhe shoqëria civile duhet të janë pjesë e monitorimit të ERA-s. Komisioni për Integrim Evropian në Kuvendin e Kosovës duhet të mbajë takime të rregullta për zbatimin e shtyllave të ndryshme të ERA-s.

IV. RAPORTI PËR VENDIN

Raporti i vendit i cili publikohet nga Komisioni Evropian është një nga dokumentet më të rëndësishme të institucioneve të BE-së për Ballkanin Perëndimor.

Raporti publikohet në baza vjetore dhe të gjeturat e raportit janë të organizuara në kriteret politike, kriteret ekonomike dhe kapitujt e acquis. Në diskursin publik raporti diskutohet vetëm disa ditë pas publikimit të tij, dhe diskutimi zakonisht fokusohet në çështjet e ndjeshme politike siç janë dialogu me Serbinë apo korrupsioni.

Raporti bënë vlerësimin e:

- gatishmërisë së vendit për tu anëtarësuar në BE; dhe
- progresit të bërë brenda vitit vlerësues.

Qëllimi i dokumentit është të këshilloj institucionet e shtetit për reformat të cilat duhet ndërmarr për të bërë progres në përmbushjen e kriterëve të Kopenhages. Të gjeturat e raportit përbëjnë bazën e takimeve të MSA-së.

Çdo vit institucionet përfshijnë rekomandimet e raportit brenda Programit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së. Nga ana e zbatimit të rekomandimeve, fatkeqësisht niveli i zbatimit është shumë i ultë. Arsyeja kryesore mbrapa nivelit të ultë të zbatimit të rekomandimeve është mungesa e vullnetit politik.

Në raportin e fundit për vendin për vitin 2019, Kosova është vlerësuar se ka “nivel të kufizuar të përgatitjes për anëtarësim në BE”, me numrin total të pikëve prej 1.8 nga gjithsej 5 pikë të mundshme. Rrjedhimisht, Kosova ishte në vendin e parafundit, duke lënë mbrapa vetëm Bosnjën me 1.6 pikë.

Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut me 3 pikë, nga totali i 5 pikëve, janë shumë para tre vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor.

Shqipëria me 2.4 pikë është në mesin e vendeve lidere (Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut) dhe atyre që çalojnë (Bosnja dhe Kosova).

Figura 6: Gatishmeria e vendeve të Ballkanit Perendimor për të marr përsipër obligimet që burojnë nga anëtarësimi në BE, për kapitull

No	Chapter	BiH	KOS	ALB	NMK	MNE	SRB	WB6 average	EU level
1	Free movement of goods	1	2	2	3	3	3	2.3	5
2	Free movement of workers	2	3	2	1	2	3	2.2	5
3	Freedom to provide services	1	3	3	3	3	3	2.7	5
4	Free movement of capital	3	2	3	3	3	3	2.8	5
5	Public procurement	2	2	2	3	3	3	2.5	5
6	Company law	2	2	3	4	4	4	3.2	5
7	Intellectual property law	3	2	2	3	4	4	3	5
8	Competition policy	2	1	2	3	3	3	2.3	5
9	Financial Services	2	3	3	3	3	3	2.8	5
10	Information society and media	1	2	3	3	3	3	2.5	5
11	Agriculture and rural development	1	2	2	3	3	2	2.2	5
12	Food safety, etc	2	2	2	4	3	3	2.7	5
13	Fisheries	2	1	1	3	1	3	1.8	5
14	Transport policy	2	1	2	3	3	4	2.5	5
15	Energy	1	2	3	3	4	3	2.7	5
16	Taxation	2	2	3	3	3	3	2.7	5
17	Economic and monetary policy	1	1	3	3	3	3	2.3	5
18	Statistics	1	2	3	3	3	3	2.5	5
19	Social policy and employment	2	1	2	3	2	3	2.2	5
20	Enterprise and industrial policy	1	3	3	3	3	3	2.7	5
21	Trans-European networks	2	2	2	4	3	3	2.7	5
22	Regional policy, etc	1		3	3	3	3	2.2	5
23	Judiciary and fundamental rights	2	1	2	2	3	2	2	5
24	Justice, freedom and security	2	1	2	3	3	2	2.2	5
25	Science and research	2	1	1	4	4	4	2.7	5
26	Education and culture	1	1	3	3	4	4	2.7	5
27	Environment	1	1	2	2	2	2	1.7	5
28	Consumer and health protection	1	1	1	3	3	3	2	5
29	Customs union	2	3	3	4	3	4	3.2	5
30	External relations	2		3	3	4	3	2.5	5
31	Foreign, security and defence policy	2		4	3	4	3	2.7	5
32	Financial control	1	2	3	3	3	3	2.5	5
33	Financial and budgetary provisions	1		2	1	1	2	1.2	5
	Average 2019	1.6	1.8	2.4	3	3	3	2.5	5

Nën këtë kapitull, ne sugjerojmë dy masa specifike. Njëra masë ka për qëllim përmirësimin e llogaridhënies në zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Vendit, ndërsa e dyta ka për qëllim përmirësimin e raportimit tek Komisioni Evropian:

- 1. Indeksi i progresit për Raportin e Vendit:** përderisa gjeturat e raportit të vendit çdo vit përfshihen në procesin e hartimit të PKZMSA-së, ne konsiderojmë se për shkak rëndësisë politike dhe publike të raportit për vendin, institucionet e Kosovës duhet të krijojnë një instrument të ri përmes të cilit do të monitorojnë përmbushjen e rekomandimeve të raportit. Indeksi i progresit duhet të organizohet në baze të gjeturave të raportit për çdo ministër dhe udhëheqës të institucioneve. Duhet të përditësohet në baza të rregullta tre-mujore dhe të bëhet publik. Kuvendi do të duhej të përdor indeksin e progresit gjatë punimeve të tij – qoftë gjatë seancave plenare apo takimeve të komisioneve.
- 2. Raportimi eficient tek Komisioni Evropian:** dy herë në vit institucionet e Kosovës dorëzojnë pranë Komisionit Evropian kontributin për përgatitjen e Raportit për Vendin. Çdo herë me qëllim të përgatitjes së materialit të nevojshëm, institucionet hartojnë kontributin respektiv nga zero. Nuk ekziston një formë e standardizuar e mbledhjes së informatave dhe prezantimit të tyre në një formë unike para Komisionit Evropian. Çdo pjesë e kontributit hartohet si pjesë e veçantë, në mungesë të ndonjë udhëzuesi apo formati të standardizuar. Një qasje e tillë shkakton dy vështirësi: (1) zyrtarë e institucioneve ngarkohen me një barrë të madhe kur çdo herë duhet të përgatitin nga zero kontributin për raportin për vendin; (2) pasi që pjesë të ndryshme të kontributit janë hartuar nga persona të ndryshëm, zyrtarët e Komisionit Evropian pranojnë një dokument i cili është jashtëzakonisht vështirë të kuptohet dhe të përdoret për qëllimet e hartimit të raportit për vendin. Rrjedhimisht, ajo çfarë ne propozojmë është përgatitjen e një forme të standardizuar për përgatitjen e kontributit për raportin e vendit. Forma do ishte e përgatitur në përputhje me kërkesat e KE-së për raportin e vendit.

V. PËRGATITJET PËR STATUSIN E VENDIT KANDIDAT

Pasi që Kosova të vlerësoj se janë përmbush parakushtet për dorëzimin e kërkesës për statusin e vendit kandidat, Kosova do të dorëzoj pranë presidencës së BE-së kërkesën për anëtarësim në BE. Kërkesa për anëtarësim do i procedohet Komisionit Evropian me qëllim të vlerësimit të kërkesës dhe përgatitjes së opinionit të Komisionit Evropian mbi meritat e kërkesës (avis).

Në mënyrë që të përgatit opinionin e vet, Komisioni Evropian do të dërgoj vendit aspirues një pyetësor voluminoz prej mbi 2,000 pyetjeve. Pyetësori mbulon të gjitha çështjet e funksionimit demokratik dhe ekonomik të shoqërisë. Po ashtu, Komisioni do të kërkoj informatat drejtpërdrejt edhe nga shoqëria civile, përfaqësitë e vendeve anëtare, organizatat ndërkombëtare, etj.

Pas pranimit të të gjitha informatave, Komisioni Evropian përgatit opinionin mbi meritat e kërkesës për anëtarësim në BE. Mbi bazën e opinionit të Komisionit Evropian, Këshilli i BE-së, dhe më pas Këshilli Evropian, marrin vendimin me unanimitet për dhënien apo jo të statusit të vendit kandidat.

Në stadet e më vonshme vendi avancon drejt hapjes së negociatave të anëtarësimit.

Deri me sot Qeveria e Kosovës nuk ka konsideruar seriozisht aplikimin për statusin e vendit kandidat. Në të kaluarën qeveritë e ndryshme janë zotuar në programet e tyre politike se do të ndërmarrin një hap të tillë, sidoqoftë kjo asnjëherë nuk ka ndodhur.

Qeveria duhet të filloj të konsideroj një qasje strategjike për të siguruar një aplikim të suksesshëm për statusin e vendit kandidat. Një aplikim i tillë kërkon përgatitje politike dhe administrative.

Përgatitjet politike

Me qëllim të ndërmarrjes së përgatitjeve për dorëzimin e suksesshëm të aplikimit për statusin e vendit kandidat, Qeveria duhet të përgatit strategjinë gjithëpërfshirëse e cila do siguroj konsensus në mesin e gjithë partive politike.

Në këtë drejtim, qeveria duhet të filloj një dialog me Kuvendin dhe Presidentin me qëllim të koordinimit të veprimeve për aplikimin. Po ashtu, Qeveria duhet të përfshijë në dialog edhe akterët jo-qeveritar.

Një qasje e tillë do siguroj se të gjithë akterët shoqëror flasin njëzëri para institucioneve BE-së për një proces i cili gëzon përkrahje nga e gjithë shoqëria. Sa i përket komunikimit me vendet anëtare të BE-së, rol të veçantë duhet të luaj Ministria e Jashtme.

Në rastin e Kosovës duhet njohur se procesi i aplikimit për statusin e vendit kandidat do jetë drejtpërdrejt i lidhur me çështjet e hapura rajonale, siç është dialogu me Serbinë, puna e Gjykatës Speciale, si dhe njohja nga pesë vendet e BE-së.

Në këtë kontekst, spektri politik duhet të fokusohet në këto çështje:

- **Krijimi i konsensusit shoqëror:**

- Fillimi i dialogut politik, brenda Kuvendit të Kosovës, për dorëzimin e aplikimit për statusin e vendit kandidat;
- Fillimi i dialogut me shoqërinë civile, biznesin, akademinë dhe media;
- Përgatitja e udhërrëfyesit për dorëzimin e suksesshëm të kërkesës për statusin e vendit kandidat.

- **Komunikimi efektiv me të gjitha palët:**

- Dakordimi i politikës së njëzëri karshi institucioneve të BE-së dhe vendeve anëtare;
- Aktivizimi i MPJ-së dhe stafit diplomatik për të komunikuar vendeve anëtare të BE-së planet e institucioneve për dorëzimin e suksesshëm të aplikimit për statusin e vendit kandidat.
- Informim i rregullt i ZBE-së dhe përfaqësive të vendeve anëtare në Kosovë mbi planet e Kosovës për aplikim.

Përgatitjet administrative

Me qëllim të demonstrimit të vullnetit politik, institucionet duhet të përshpejtojnë zbatimin e detyrimeve që burojnë nga procesi integruar. Në këtë drejtim, vëmendje e veçantë duhet të kushtohet rritjes së shkallës së zbatimit të MSA-së, ERA-së dhe Programit për Reforma Ekonomike (ERP).

Një gjë e tillë kërkon kapacitete të mirëfillta administrative. Qeveria duhet të bëjë vlerësimin e kapaciteteve në kuadër të strukturave kyçe administrative për integrim Evropian, siç është AIE, DIEKP dhe departamentet ligjore. Bazuar në një vlerësim të tillë duhet marr hapat për rritjen e kapaciteteve administrative të këtyre trupave.

Me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë së kapaciteteve administrative qeveria duhet të instaloj një menaxhim rigoroz të performancës të shërbimit civil. Po ashtu, qeveria duhet të siguroj rritjen e fondit për bursën Skema e Profesionistëve të Rinj (YCS), me qëllim të ngritjes së kapaciteteve afatgjata të institucioneve në procesin integrues.

Përderisa institucionet kanë arritur të konsolidojnë strukturat e nevojshme për planifikimi dhe zbatim, në afat-shkurt qeveria duhet të avancoj procesin e përafrimit të legjislacionit nacional me atë të BE-së.

Me qëllim të përshpejtimit të procesit të përafrimit, qeveria duhet: të përcaktoj indikatorët të qartë për përafrim për çdo kapitull të legjislacionit të BE-së; të aktivizoj strukturat ndërqeveritare për integrim, të përgatit metodologji për monitorimin e zbatimit të legjislacionit; të fillon përdorimin e Vlerësimi të Ndikimit Rregullues (RIA); dhe të alokoj burimet e nevojshme për përkthimin e acquis. Po ashtu, duhet të sigurohet se fondet e BE-së janë duke mbështetur përshpejtimin e përafrimit me acquis.

Me qëllim të përgatitjes sa më të mirë për aplikimin për statusin e vendit kandidat, qeveria do të duhej të bënte simulimin e përgjigjeve në pyetësorin e Komisionit Evropian. Në këtë mënyrë, qeveria do kuptonte se ku janë pikat e dobëta të institucioneve – para pranimit zyrtar të pyetësorit nga ana e Komisionit Evropian.

Në këtë kontekst, këto janë hapa administrativ që duhet ndërmarr:

Fuqizimi i planifikimit dhe zbatimit të reformave integruese:

- Shkalla e zbatimit prej së paku 90% zbatim i MSA, ERA dhe ERP;
- AIE në rolin udhëheqës;
- Fuqizimi i kapaciteteve administrative në AIE, DIEKP dhe departamentet ligjore;
- Aktivizimi i trupave ndërqeveritare për integrim.

Fuqizimi i procesit të përafrimit ligjor:

- Vlerësim i kapaciteteve të AIE, DIEKP dhe departamenteve ligjore për procesin e përafrimit;
- Instalimi i një kornize të konsoliduar për menaxhimin e performancës;
- Zbatimi i suksesshëm i skemës YCS;
- Përcaktimi i indikatorëve të përafrimit dhe zbatimit për secilin kapitull acquis;
- Programimi i asistencës së BE-së në mbështetje të procesit të përafrimit;
- Në fushat komplekse të aplikohet vlerësimi ex-post i vlerësimit të legjislacionit përmes asistencës së BE-së;
- Intensifikimi i bashkëpunimit me Shqipërinë në përkthimin e legjislacionit;
- Zhvillimi i mjeteve IT për menaxhimin e procesit të përafrimit.

Testimi i gatishmërisë për kompletimin e pyetësorit:

- Simulim i përgatitjes së përgjigjeve në pyetësor (duke përdorur njërin nga pyetësorët e vendeve të rajonit).

Në kuptimin e hapave procedural para Kosovës, janë gjithsej shtatë hapat para nesh.

Figura 7: Hapat e ardhshëm drejt Statusit të Vendit Kandidat

- 1** **KOSOVA E DORËZON KËRKESËN PËR ANËTARËSIM NË BE, PRANË PRESIDENCËS SË KËSHILLIT TË BE-SË**
- 2** **KËSHILLI PËR ÇËSHTJE TË PËRGJITHSHME KËRKON NGA KOMISIONI EVROPIAN OPINIONIN MBI MERITAT E KËRKESËS**
- 3** **KOMISIONI DËRGON PYETËSORIN PËR KOSOVËN: MË SHUMË SE 2,000 PYETJE PËR ÇDO FUSHË TË LEGJISLACIONIT TË BE-SË**
- 4** **KOSOVA PËRGATIT PËRGJIGJET NË PYETËSORIN DHE I DORËZON PRANË KOMISIONIT (ZAKONISHT BRENDË 3 MUAJVE)**
- 5** **KOMISIONI PËRGATIT OPINIONIN E TIJ (AVIS) BAZUAR NË PËRGJIGJET E INSTITUCIONEVE DHE KONTRIBUTET E TJERA**
- 6** **KOMISIONI DORËZON OPINIONIN E TIJ PRANË KËSHILLIT, ME VLERËSIMIN E TIJ NËSE KOSOVA KA PËRMBUSHUR KRITERET PËR TË FITUAR STATUSIN E VENDIT KANDIDAT**
- 7** **NË RAST TË MENDIMIT POZITIV, KËSHILLI I BE-SË, DHE MË PASTAJ KËSHILLI EVROPIAN, VENDOS ME UNANIMITET TË JAP KOSOVËS STATUSIN E VENDIT KANDIDAT PËR ANËTARËSIM NË BE**

VI. INSTRUMENTI I ASISTENCËS SË PARA-ANËTARËSIMIT (IPA)

Në harmoni me studimin tonë të fundit “UDHËRRËFYES PËR IPA III: mësimet, risitë dhe hapat e ardhshëm për 2021-2027” ne kemi identifikuar shtatë mësimet nga IPA II dhe mbi këtë bazë kemi rekomanduar udhërrëfyesin me dhjetë hapa specifik që duhet ndjekur nga ana e institucioneve me qëllim të përgatitjes sa më të mirë për IPA III 2021-2027.

Ne kemi identifikuar shtatë mësimet nga IPA II:

- IPA II është shumë relevante;
- IPA II është e orientuar drejt ndryshimit;
- Ekziston mungesa e pronësisë dhe sindromit të "botës paralele";
- Kornizë e planifikimit kombëtar është e brishtë;
- Mungesa e vendimmarrjes empirike dhe proceseve të strukturuar;
- Mungesa e 'kthyeshmërisë automatike' të fondeve IPA;
- Defektet e asistencës teknike.

Figura 8: Shtatë mësimet nga IPA II



Ne kemi rekomanduar dhjetë hapa specifik që duhet ndjekur nga ana e institucioneve me qëllim të përgatitjes sa më të mirë për IPA III 2021-2027.

Figura 9: Dhjetë hapa për zbatimin e IPA III



VII. DONACIONET BILATERALE

Që nga viti 1999, komuniteti ndërkombëtar i donatorëve është mjaft aktiv në Kosovë. BE-ja është donatori më i madh, i përcjellur nga SHBA, Gjermania, Suedia, Zvicra, Norvegjia, Luksemburgu, Mbretëria e Bashkuar, Japonia, etj. Institucionet Financiare Ndërkombëtare të cilat janë aktive në Kosovë janë: Banka Evropiane e Investimeve (BEI), Banka Botërore (BB), Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Banka Zhvillimore Gjermane (KfW), Banka Zhvillimore e Këshillit të Evropës (CEB) dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).

Struktura qeveritare përgjegjëse për koordinimin e donacioneve është Departamenti i Asistencës Zhvillimore (DAZH), brenda Agjencisë për Integrim Evropian. Me qëllim të ushtrimit të mandatit të tyre, DAZH çdo vit përgatit raportin vjetor për koordinimin e donacioneve.

Sipas raportit të fundit të Qeverisë për koordinimin e donacioneve 2016, Kosova ka pranuar 164 milion EURO donacione në vitin 2016. Sektorët që kanë përfituar më së shumti janë:

- Qeverisja dhe shoqëria civile: 57 milion;
- Arsimi: 17.6 milion;
- Përmirësimi i menaxhimit të ujërave: 14 milion;
- Përmirësimi i infrastrukturës: 10 milion;
- Mbështetje bizneseve: 9.5 milion.

Me qëllim të koordinimit ndërqeveritar, brenda çdo ministrie janë themeluar Departamente për Koordinim të Politikave dhe Integrim Evropian. Këto trupa janë përgjegjës për koordinimin e donacioneve brenda ministrive.

Qeveria po ashtu ka themeluar strukturën e përbërë prej tre niveleve për koordinimin e donacioneve:

- Forumi i Nivelit të Lartë (FNL) i cili është trup me i lartë koordinues i udhëhequr nga Kryeministri, me pjesëmarrjen e ministrave dhe ambasadorëve. FNL vendos prioritetet shumë-vjeçare dhe vjeçare për zbatimin e asistencës zhvillimore;

- Grupet Punuese Sektoriale (GPS) janë trupat përgjegjës për diskutimin e prioriteteve dhe sfidave sektoriale. Ato udhëhiqen nga niveli i Sekretarëve të Përgjithshëm, me pjesëmarrjen e menaxhmentit të nivelit të mesëm;

- Nën-grupet Punuese Sektoriale (NGPS) janë trupat përgjegjës për diskutimin e prioriteteve dhe sfidave në nivelin nën-sektorial. Ato udhëhiqen nga Sekretarët e Përgjithshëm, me pjesëmarrjen e ekspertëve.

Përtej strukturave formale, AIE në bashkëpunim me ZBE zhvillon dialog të rregullt joformal me komunitetin e donatorëve nën ombrellën e Forumit për Koordinimin e Donatorëve.

Monitorimi dhe raportimi i asistencës së donatorëve bëhet përmes Platformës për Menaxhimin e Ndihmës së Jashtme (Aid Management Platform - AMP). AMP shërben si bazë për përgatitjen e raportit të donatorëve.

Kosova ballafaqohet me pesë sfida në fushë e koordinimit të donacioneve:

- **Harmonizimi i donacioneve me politikat nacionale:** Donacionet nuk mund të zgjidhin të gjitha problemet e Kosovës. Donacionet duhet të ndërveprojnë me politikat dhe buxhetin nacional. Me fjalë të tjera, donacionet e jashtme janë të suksesshme aq sa janë të suksesshme politikat dhe buxheti i vendit. Në këtë drejtim, Kosova vuan nga mungesa e ndërlihdjes në mes prioriteteve nacionale dhe alokimeve financiare. Ekziston një inflacion i dokumenteve strategjike të cilat e kanë bërë një planifikim të mirëfilltë nacional të pamundur.
- **Mungesa e procedurave të ligjore dhe udhëzimeve të qarta për donatorët:** momentalisht mungojnë procedurat e qarta ligjore që qeverisin bashkëpunimin në mes institucioneve dhe donatorëve. Donatorët e ndryshëm përdorin qasje të ndryshme në bashkëpunimin e tyre me institucionet. Kjo qasje krijon një mjedis i cili krijon procese paralele dhe shkakton kosto koordinuese.
- **Mungesa e kapaciteteve administrative në ministritë linjës:** koordinimi i donacioneve duhet të fuqizohet në nivelin ministror. Çdo ministri ka Departamente për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave (DIEKP). DIEKP-të duhet të janë gardianët e asistencës së donatorëve në nivelin sektorial. Përderisa deri më sot mjaft vëmendje është kushtuar fuqizimit të kapaciteteve të AIE-së, vëmendja politike për ngritjen e kapaciteteve administrative duhet të kaloj tek ministritë e linjës.

- **Koordinimi i mangët ndër-institucional:** në vitin 2015 Qeveria ka themeluar strukturën e përbërë prej tre niveleve për koordinimin e donacioneve. Sidoqoftë, këto strukturat nuk janë funksionalizuar. Koordinimi i donacioneve në nivelin sektorial dhe nën-sektorial është pothuaj jo-ekzistent.
- **Mungesa e të dhënave:** koordinimi i donacioneve vuan nga mungesa e të dhënave mbi ndikimi e donacioneve në qeverisjen dhe jetën e përditshme. Nuk ekzistojnë sistemet e monitorimit të bazuara në indikatorët e matshëm. Raportet periodike dhe vjetore nuk përgatiten. Një gjendje e tillë nuk inkurajon një proces vendim-marrës të bazuar në të dhëna empirike.

Në mënyrë që të adresohen këto sfida, institucionet e Kosovës duhet të konsiderojnë këto pesë hapa:

1. Planifikimi i integruar strategjik: Qeveria e Kosovës, me mbështetjen e BE-së, ka ngritur Sistemin e Planifikimit të Integruar (IPS) si qasje holistike, sistematike dhe empirike për të mbështetur planifikimin nacional. IPS ka ngritur edhe strukturat e nevojshme për të siguruar se të gjitha burimet financiare mbështesin një agjendë të vetme zhvillimore. Në këtë drejtim, Zyra e Kryeministrit, Ministria e Financave dhe Agjencia për Integrim Evropian luajnë rol kyç. Rrjedhimisht, institucionet duhet të sigurojnë se koordinimi i donacioneve të vendoset nën ombrellën e IPS-it. Kjo do sigurojë: (1) një fokus më të madh politik në reformat kyçe; (2) pronësi institucionale; (3) sinergji në mes prioriteteve dhe buxhetimit; (4) një harmonizim më të madh në mes procedurave administrative. Po ashtu, qeveria duhet të synojë të krijoj një Program për Investime Strategjike. Kjo do të mund të bëhet duke vazhduar punën e bërë në hartimin e Programit për Investimet Infrastrukturore, të përgatitur në kuadër të procesit të Berlinit.


2. Kompletimi i kornizës ligjore për koordinimin e donacioneve: Qeveria duhet të vendos rregullat e qarta me shkrim për koordinimin e donacioneve në Kosovë. Këto rregulla duhet të sigurojnë harmonizimin e Ligjit për Marrëveshje Ndërkombëtare me rregullat e koordinimit të donacioneve. Kjo do sigurojë një rritje të pronësisë dhe transparencës së asistencës së donatorëve dhe njëkohësisht do të ofroj themele për koordinimin më koherent të donacioneve. Qëllimi i kompletimit të kornizës ligjore duhet të jetë edhe centralizimi i vendim-marrjes nën kornizën e IPS-it në mënyrë që të sigurohet se donacionet janë duke mbështetur prioritetet e dakorduara nën ombrellën e IPS-it, dhe në përputhje me prioritetet dhe buxhetin nacional.

3. **Punësimi i YCS në ministritë e linjës:** Bursa YCS është vërtetuar të jetë instrument efektiv në fuqizimin e administratës publike. Në këtë drejtim, qeveria duhet të marr hapa të vendosur për ngritjen e kapaciteteve në nivelin ministror.

4. **Takimet e rregullta të strukturave për koordinimin e donacioneve:** takimet e strukturave institucionale duhet të intensifikohen. Kalendari vjetor i takimeve duhet të miratohet nga Qeveria. Strukturat duhet të shërbejnë tre qëllimeve në nivelin sektorial dhe nën-sektorial: (1) të monitoroj progresin drejt përmbushjes së indikatorëve; (2) të identifikoj sfidat; (3) të propozoj prioritete. Forumi i Nivelit të Lartë duhet të mbledhet dy herë në vit për të ofruar udhëzime përkitazi me prioritetet vjetore dhe shumë-vjeçare, të rishikoj progresin e bërë dhe të dakordoj veprime korigjuese.

5. **Vendim-marrja empirike:** AMP duhet të përdoret për mbledhjen e të dhënave dhe për vendim-marrje institucionale. Kjo kërkon funksionalizimin e plotë të AMP-së dhe dakordimin e indikatorëve monitorues në nivelin sektorial dhe nën-sektorial.

Figura 10: Nga sfidat e koordinimit të donacioneve në hapat e ardhshëm



VI. REKOMANDIMET

Për liberalizimin e vizave:

1. Arritja e rezultateve në kuadër të luftës kundër korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimin të organizuar;
2. Vullneti i qartë politik për reformat e sundimit të ligjit;
3. Progres në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve;
4. Komunikimi i shtuar me vendet anëtare të BE-së.

Për MSA:

1. Indeksi i progresit për MSA;
2. Indikatorët e përafrimit me acquis për secilin kapitull;
3. Takime mujore të trupave ndër-qeveritar për integrim Evropian;
4. Raporti kuartal në Qeveri dhe Kuvend.

Për ERA 2 duhet të sigurohet respektimi i tre parimeve kyçe:

1. Prioritetet specifike;
2. Mekanizimi efektiv i monitorimit;
3. Gjithpërfshirja.

Për Raportin e Vendit:

1. Indeksi i progresit për Raportin e Vendit;
2. Raportimi eficient tek Komisioni Evropian.

Për statusin e Vendit Kandidat:

1. Kosova e dorëzon kërkesën për anëtarësim në BE, pranë Presidencës së Këshillit të BE-së;
2. Këshilli për Çështje të Përgjithshme kërkon nga Komisioni Evropian opinionin mbi meritat e kërkesës;
3. Komisioni dërgon pyetësin për Kosovën: më shumë se 2,000 pyetje për çdo fushë të legjislativës të BE-së;

4. Kosova përgatit përgjigjet në pyetësorin dhe i dorëzon pranë Komisionit;
5. Komisioni përgatit opinionin e tij (avis) bazuar në përgjigjet e institucioneve dhe kontributet e vendeve anëtare, shoqërisë civile, organizatave ndërkombëtare, etj;
6. Komisioni dorëzon opinionin e tij pranë Këshillit, me vlerësimin e tij nëse Kosova ka përmbushur kriteret për të fituar statusin e vendit kandidat;
7. Në rast të mendimit pozitiv, Këshilli i BE-së, dhe më pastaj Këshilli Evropian, vendos me unanimitet të jap Kosovës statusin e vendit kandidat për anëtarësim në BE.

Për IPA III:

1. Qeveria mandaton Komitetin për Planifikim Strategjik për të përgatitur qëndrimin e Kosovës për IPA III;
2. Drafti i parë i qëndrimit të Kosovës për IPA III diskutohet dhe miratohet në Qeveri;
3. Qeveria prezanton qëndrimin e Kosovës për IPA III Komisionit për Integrim Evropian në Kuvendin e Kosovës;
4. Qeveria prezanton qëndrimin e Kosovës për IPA III palëve të jashtme;
5. Qëndrimi i Kosovës për IPA III miratohet në Qeveri;
6. Qëndrimi i Kosovës për IPA III prezantohet në Kuvend;
7. Dialogu në mes Qeverisë dhe Komisionit Evropian për prioritetet dhe projektet e IPA III;
8. IPA III 2021-2027 prioritetet dhe projektet miratohen;
9. IPA III programimi për periudhën 2021-2027 diskutohet rregullisht në Komitetin për Planifikim Strategjik dhe Qeveri;
10. Qeveria rregullisht informon Kuvendin për zbatimin e IPA III.

Për koordinimin e donacioneve:

1. Planifikimi i integruar strategjik;
2. Kompletimi i kornizës ligjore për koordinimin e donacioneve;
3. Punësimi i YCS në ministritë e linjës;
4. Takimet e rregullta të strukturave për koordinimin e donacioneve;
5. Vendim-marrja empirike.

Figura 11: KOSOVA–BE 2.0 Hapat e ardhshëm në procesin integruar të Kosovës

LIBERALIZIMI I VIZAVE

1. Arritja e rezultateve në kuadër të luftës kundër korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimit të organizuar;
2. Vullneti i qartë politik për reformat e sundimit të ligjit;
3. Progres në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve;
4. Komunikimi i shtuar me vendet anëtare të BE-së.

MARRËVESHJA STABILIZIM ASOCIMI

5. Indeksi i progresit për MSA;
6. Indikatorët e përafrimit me acquis për secilin kapitull;
7. Takime mujore të trupave ndër-qeveritar për integrim Evropian;
8. Raporti kuartal në Qeveri dhe Kuvend.

AGJENDA E REFORMAVE EVROPIANE 2

9. Prioritetet specifike;
10. Mekanizmi efektiv i monitorimit;
11. Gjithëpërfshirja.

RAPORTI I VENDIT

12. Indeksi i progresit për Raportin e Vendit;
13. Raportimi eficient tek Komisioni Evropian.

STATUSI I VENDIT KANDIDAT

14. Kosova e dorëzon kërkesën për anëtarësim në BE, pranë Presidencës së Këshillit të BE-së;
15. Këshilli për Çështje të Përgjithshme kërkon nga Komisioni Evropian opinionin mbi meritat e kërkesës;
16. Komisioni dërgon pyetësorin për Kosovën: më shumë se 2,000 pyetje për çdo fushë të legjislacionit të BE-së;
17. Kosova përgatit përgjigjet në pyetësorin dhe i dorëzon pranë Komisionit;
18. Komisioni përgatit opinionin e tij (avis) bazuar në përgjigjet e institucioneve dhe kontributet e tjera;
19. Komisioni dorëzon opinionin e tij pranë Këshillit, me vlerësimin e tij nëse Kosova ka përbushur kriteret për të fituar statusin e vendit kandidat;
20. Në rast të mendimit pozitiv, Këshilli i BE-së, dhe më pastaj Këshilli Evropian, vendos me unanimitet të jap Kosovës statusin e vendit kandidat për anëtarësim në BE.

IPA III

21. Qeveria mandaton Komitetin për Planifikim Strategjik për të përgatitur qëndrimin e Kosovës për IPA III;
22. Drafti i parë i qëndrimit të Kosovës për IPA III diskutohet dhe miratohet në Qeveri;
23. Qeveria prezanton qëndrimin e Kosovës për IPAIII Komisionit për Integrim Evropian në Kuvendin e Kosovës;
24. Qeveria prezanton qëndrimin e Kosovës për IPA III palëve të jashtme;
25. Qëndrimi i Kosovës për IPA III miratohet në Qeveri;
26. Qëndrimi i Kosovës për IPA III prezantohet në Kuvend;
27. Dialogu në mes Qeverise dhe Komisionit Evropian për prioritetet dhe projektet e IPA III;
28. IPA III 2021-2027 prioritetet dhe projektet miratohen;
29. IPA III programimi për periudhën 2021-2027 diskutohet rregullisht në Komitetin për Planifikim Strategjik dhe Qeveri;
30. Qeveria rregullisht informon Kuvendin për zbatimin e IPA III.

KOORDINIMI I DONACIONEVE

31. Planifikimi i integruar strategjik;
32. Kompletimi i kornizës ligjore për koordinimin e donacioneve;
33. Punësimi i YCS në ministritë e linjës;
34. Takimet e rregullta të strukturave për koordinimin e donacioneve;
35. Vendim-marrja empirike.

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Kriteret e udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave

Figura 2: Si të adresohen sfidat e liberalizimit të vizave?

Figura 3: Hapat e ardhshëm për liberalizimin e vizave për Kosovën

Figura 4: Kriteret e mekanizmit për pezullimin e liberalizimit të vizave

Figura 5: Procesi integrues i vendeve të Ballkanit Perëndimor

Figura 6: Gatishmëria e vendeve të Ballkanit Perëndimor për të marr përsipër obligimet që burojnë nga anëtarësimi në BE, për kapitull

Figura 7: Hapat e ardhshëm drejt Statusit të Vëndit Kandidat

Figura 8: Shtatë mësimet nga IPA II

Figura 9: Dhjetë hapa për zbatimin e IPA III

Figura 10: Nga sfidat e koordinimit të donacioneve në hapat e ardhshëm

Figura 11: KOSOVA–BE 2.0 Hapat e ardhshëm në procesin integrues të Kosovës

(faqe qëllimisht lënë zbrazët)

